

Metodologjia jonë

Ndërmjetësimi integrues është një qasje gjithëpërfshirëse ndaj zgjidhjes së konflikteve ndër-etnike. Ai ngërthen një sërë teknikash, të cilat bazohen në ndërmjetësimin klasik, për t'u ndihmuar udhëheqësve lokal me qasjen e tyre në zgjidhjen e problemeve nga niveli më i ulët kah më i larti. Ndërmjetësimi integrues kombinon pesë elemente themelore:

- Ndërmjetësimin
- Këshillimin
- Trajnimin profesional
- Hulumtimin dhe analizat
- Avokimin

Për t'i afruar udhëheqësit, organizohen një varg ndërmjetësimesh, takimesh të përbashkëta dhe trajnimesh profesionale te bazuara në konsultime individuale me ata.

Ndërmjetësimin përqendrohen në zgjidhjen e problemeve urgjente, ndërsa trajnimet profesionale synojnë kërkimin e zgjidhjeve afat-mesme dhe afat-gjata. Në seancat e trajnimit, pjesëmarrësit nxiten të krijojnë plane veprimi dhe nisma për krijimin e besimit të cilat duhet të zbatohen në komunat e tyre.

Problemet për të cilat identifikohen shkaqet sistematike të shkaktuara jashtë fushëveprimit të nivelit komunal hulumtohen më tej, ndërsa rekomandimet avokohen tek institucionet përkatëse.

Përmes kombinimit të këtyre elementeve të ndryshme krijohet një shtytje integruese në mbështetje të zgjidhjeve efektive dhe të qëndrueshme.

**Marrëveshjet nuk krijojnë paqe;
njerëzit po.**

Kontaktet

Për informata të mëtejme rreth projekteve tona si dhe implementimit të tyre ju lutemi të kontaktoni:

**CSSProject for Integrative Mediation
Deutscher Bundestag
Büro Dr. Schwarz-Schilling
Platz der Republik 1
11011 Berlin
Germany**

**Tel. +49 (30) 227-77417
Fax. +49 (30) 227-76417**

**info@cssproject.org
www.cssproject.org**

Mbështetni CSSP-në

Për informata se si mund të mbështetni CSSP-në, ju lutemi kontaktoni:

**CSSP e.V.
Dr. Juan Diaz
Auguststrasse 72
10117 Berlin
Germany**

**Deutsche Bank Berlin
Bank Account: 66 999 46 02
Bank Code: 100 700 24
IBAN: DE89100700240 669994600
SWIFT CODE: DEUTDE33330**

**Regjistruar nga:
Vereinsregister Amtsgericht Charlottenburg
von Berlin VR 25 742 B**



**Shoqata për
Ndërmjetësim Integrues**

Ne i afrojmë udhëheqësit lokal

Kush jemi ne

CSSP është zhvilluar nga mandati i Ndërmjetësuesit Ndërkombëtar në Bosnjë dhe Hercegovinë, Dr. Christian Schwarz-Schilling (1995 – 2004). Është menduar si një projekt i mësimave të nxjerrura që do të përqendrohej në Evropën juglindore. Në verë të vitit 2006, CSSP e.V. u regjistrua si një shoqatë jo-profitabile në Berlin, Gjermani.

Që nga viti 2005, CSSP ka zhvilluar vegla për ndërmjetësim dhe trajnim për t'u ndihmuar udhëheqësve lokal në krijimin e besimit dhe në bashkëpunim. Ekipi tashmë ka kaluar prej ndërmjetësimit krye-sisht *ad hoc* në një qasje më sistematike.

Projektet tona synojnë përmirësimin e bashkëpunimit ndër-etnik dhe dialogut si dhe krijimin e mekanizmave për krijimin e besimit në mesin e udhëheqësve lokal. Të gjitha projektet implementohen nga ekspertë të përkushtuar dhe të kualifikuar që punojnë në ekipe për të arritur rezultate maksimale me inpute minimale. Fleksibiliteti jonë na mundëson të mbesim një ekip dinamik mobil në terren me zyrë qendrore në Berlin.

Çfarë bëjmë ne

CSSP fuqizon individët lokal përmes proceseve të ndërmjetësimit të përshtatur për atë ambient. Udhëheqësve lokale u ofrojmë trajnime në ndërmjetësim, negocijim dhe teknika e aftësi të zgjidhjes së problemeve, si dhe ofrojmë këshilla profesionale për zgjidhjen e konflikteve.

Poashtu CSSP forcon ndërmjetësimin profesional në zonat e veta cak për të rritur aftësitë dhe për të ofruar alternativa kredibile për konfliktin. CSSP punon në krijimin e paqes prej nivelit më të ulët kah më i larti dhe në forcimin e aftësisë së bashkësive për të tejkaluar sfidat nga konflikti dhe të përqendrohen në zhvillime demokratike (politike, ekonomike, sociale).

CSSP nuk synon të zëvendësojë apo të merr pronësinë mbi procesin e paqes. Ajo plotëson punën që bëhet në terren. Qëllimi jonë është që t'i lëmë vendimet dhe zgjidhjet në duart e udhëheqësve lokal.



Projektet tona

CSSP është në rend të parë e përqendruar në Ballkanin perëndimor. Mirëpo, në vitet e fundit në poashtu kemi zhvilluar dhe implementuar projekte në rajone tjera, dhe kemi mbajtur trajnime në Bon, Bruksel, Hanoi, dhe Varshavë.

Bosnje dhe Hercegovinë

Në korrik 2007, CSSP ka rifilluar aktivitetet e saj me një projekt kërkimor mbi nivelin e bashkëjetesës si dhe me një vlerësim të situatës politike në komunat e mundshme cak. Ky projekt do të fillojë më 2008.

Kosovë

Kosova është shtylla kryesore e përpjekjeve të CSSP-së në sferën e ndërmjetësimit integruar. Punojmë në disa komuna në përmirësimin e bashkëpunimit ndër-etnik dhe lehtësojmë zhvillimin e një ambienti të qëndrueshëm politik.

Maqedoni

CSSP ofron trajnim për udhëheqësit lokal në komunën e Strugës me një theks në forcimin e marrëdhënieve ndër-etnike dhe përmirësimin e koordinimit të këshillit komunal. CSSP punon me partnerë lokal dhe do të zhvillojë më shumë projekte në 2008.

SEEMF

Forumi për Ndërmjetësim në Evropën Juglindore (South Eastern Mediation Forum - SEEMF) është një rrjet i ndërmjetësuesve në rajon i cili ishte themeluar nga CSSP-ja në Sarajevë më 2005. Përveç organizimit të konferencave dhe nxitjes së komunikimit, ne do të themelojmë një platformë interaktive mbi ndërmjetësimin për Evropën juglindore.

www.seemf.cssproject.org

Serbi

CSSP në konsultim me UNDP është duke zhvilluar ndërmjetësimin në korniza të ligjit të propozuar mbi anti-diskriminimin. Poashtu punojmë në zhvillimin e ndërmjetësimit si një vegël për zgjidhjen e konfliktit në Sërbinë jugore.

Shri-Lankë

CSSP ishte aktive në Shri-Lankë më 2005 me shkëmbimet profesionale dhe trajnimet në ndërmjetësim. Për shkak të intenzitetit të rritur të luftimeve që nga 2006, projektet e parashikuara janë vënë në pritje. Ekipi vazhdon të monitorojë gjendjen për të përcaktuar se kur mund të vazhdojë me projektet e saj.